

Nr. 3035 prot.

24.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

TITULLI I AMENDAMENTIT: RITJA E SHPENZIMEVE KORRENTE NË TABELËN NR 1, NË KODIN 11/09450 DHE NË KODIN 11/09770 ME QËLLIM RITJEN E GRANTEVE NË MËSIMDHËNIE DHE NË KËRKIME SHKENCORE.

KËRKUES:

Znj. Monika Kryemadhi

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI:

“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN
PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

BAZA LIGJORE:

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:

Pas protestave studentore të vitit 2018, asnjë ndryshim real buxhetor nuk është bërë për arsimin e lartë për të plotësuar kërkesat e shprehura nga vetë studentët. Arsimi i lartë dhe kërkimi shkencor vazhdojnë të jenë të nëninvestuar duke e bërë kështu të pamundur rritjen e cilësisë së universiteteve. Me qëllim rritjen e pagave të pedagogëve dhe përgjysmimin e tarifave studentore, amendimi propozon që në zërin shpenzime korente për Arsimin e Lartë të shtohen edhe 5 miliard lekë. Ky buxhet që shtohet i shkon grantit për mësimdhënie.

Me qëllim shtimin e projekteve të kërkimit shkencor, hapjen e doktoraturave dhe ngritjen e laboratorëve modern të kërkimit shkencor, propozohet që në zerin për kërkimin shkencor të shtohet vlera prej 5 miliard lekësh. Kërkimi shkencor nuk është i domosdoshëm vetëm për akademikët dhe studentët, por për të gjithë profesionet. Në ditët e sotme bazuar në rëndësinë e kërkimit , ai duhet të kthehet në një nga misionet kryesore të Universiteteve dhe qeverisë duke investuar dhe duke krijuar hapësira të nevojshme për kultivimin e një kërkimi shkencor të shëndetshëm.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvetit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”,* parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

MONIKA KRYEMADHI



ANEKSI 1

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2022 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Në Nenin 1 të shtohet pika: "Për buxhetin e vitit 2022 të RRITEN SHPENZIMET KORRENTE NE KODIN 11/09450 DHE NË KODIN 11/09770 ME QELLIM RRITJEN E GRANTEVE NË MËSIMDHËNIE DHE NË KËRKIME SHKENCORE të Ministrisë së Arsimit.